



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 800/7 Prot.

Durrës, më 5 . 3 .2025

VENDIM

Nr. 20 , datë 5 . 3 . 2025

PËR

"HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER I SHKENCAVE NË "ENVIRONMENTAL, CULTURAL AND TOURISM ECONOMICS" NË GJUHËN ANGLEZE DHE NË GJUHËN ITALIANE "ECONOMIA DELL'AMBIENTE, DELLA CULTURA E DEL TURISMO", PRANË DEPARTAMENTIT TË TURIZMIT, FAKULTETI I BIZNESIT, UAMD ME FAKULTETIN E EKONOMISË, UNIVERSITETI LA SAPIENZA, ROMË"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, gërma b; neni 80; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD-së, neni 68; Rregulloren e UAMD-së neni 51, si edhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 715/2 prot., datë 04.03.2025, në mbledhjen e datës 05.03.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Environmental, Cultural and Tourism Economics" në gjuhën angleze dhe në gjuhën italiane "Economia dell'Ambiente, della Cultura e del Turismo", pranë Departamentit të Turizmit, Fakulteti i Biznesit, UAMD me Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti La Sapienza, Romë, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Zv. Rektorët
- Drejtuesi i Njesisë Kryesore
- Drejtuesi i Njesisë Bazë
- Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave

4. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

